



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

---

**OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË  
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË**

**Faza e tretë**

**Viti shkollor 2022-2023**

**25 prill 2023**

**ZGJIDHJET**

## Pyetja 1

### Dokumenti 1

I akuzuari duke u sjellë para Sir John Lenthall, ai kërkoi pse ata nuk do të shkonin dhe të drejtoheshin në kishën e tyre të famullisë, sipas ligjit të Elizabetës 35.\* Ata u përgjigjën:

1. Se ligji i 35 Elizabetës nuk ishte një ligj i vërtetë, sepse ishte bërë nga peshkopët; dhe se ata nuk do t'i binden asaj.
2. Që nuk do të shkonin në kishat e tyre famullitare. Se ato kisha nuk ishin kisha të vërteta; dhe se nuk kishte kishë të vërtetë, përveçse aty ku mblihdeshin besimtarët.
3. Se mbreti nuk mund të bënte një ligj të përsosur, sepse nuk ishte njeri i përsosur.
4. Se ata nuk duhet t'i binden mbretit përveçse në çështje civile. \*Akti i vitit 1593 që detyron pjesëmarrjen në kishat e famullisë anglikane

Raport nga zyrtarët mbretërorë që akuzojnë një grup anabaptistësh se janë takuar fshehurazi në një shtëpi private, 1642

### Dokumenti 2



Një skicë e flamurit të betejës të kapitenit Huker, oficer në Ushtrinë Parlamentare, i mbajtur gjatë Luftës Civile Angleze

Argumentoni nëse Lufta Civile Angleze (1642-1649) u motivua kryesisht nga arsye fetare apo politike.

10 pikë

- Lufta Civile në Angli pati një karakter të përzier për sa i përket motiveve të saj.
- Një pjesë e motiveve ishin fetare duke qene se, përgjithësisht përkrahësit e katolicizmit dhe të protestantizmit (i njohur si anglikanizëm në Angli) u rreshtuan në ane të kundërta të konfliktit civil. P.sh. "puritanet" ishin nder grupimet kryesore nder përkrahësit e Parlamentit.
- Dokumenti 1 i referohet pikërisht këtij dimensionit fetar të luftës civile ku theksohet vullneti i një grupi besimtarësh për të vendosur vete për mënyrën e ushtrimit të lirisë fetare në kundërvënien ndaj vendimeve mbretërore për këtë aspekt. Kundërvënien fetare kishte filluar prej kohësh mes influencës së kishës katolike dhe asaj kombëtare anglikane dhe kjo gjë gjeti shprehjen e vet edhe në luftën civile.
- Nga ana tjetër, konflikti civil u nxit padyshim edhe nga motive politike. Kontradiktat mes sundimit absolutist bazuar në "te drejtën hyjnore" të mbretërisë dhe përkrahësve të saj dhe rendit kushtetues me primatin e ligjit të barabartë për të gjithë të mbështetur nga organi i zgjedhur (Parlamenti) dhe përkrahësit e këtij të fundit, gjeten shprehjen e tyre në kuadër të luftës civile.
- Ky është edhe kuptimi i dokumentit 2 ku, në flamurin e përdorur nga një prej komandanteve të ushtrisë parlamentare, simboli dominues është ai i Magna Kartës si dokumenti i parë me natyrën e njëfarë "kushtetute" që synonte kufizimin e pushtetit absolutist të monarkisë dhe ndarjen e tij me atë të Parlamentit si organi përfaqësues i vullnetit të popullit shprehur nëpërmjet zgjedhjeve.

## Pyetja 2

### Dokumenti 1

"Lufta e Ftohtë mund të ishte shmangur vetëm nëse Bashkimi Sovjetik nuk do të ishte pushtuar nga bindjet, si për pagabueshmërinë e botës komuniste, ashtu edhe për pashmangshmërinë e një bote komuniste."

Arthur Schlesinger Jnr, historian

### Dokumenti 2

"[Lufta e Ftohtë] nuk ishte aq shumë si pasojë e veprimeve të Kremlinit, sesa nga frika për përmbysjen social-ekonomike, nacionalizmin revolucionar... dhe vakumet euroaziatike të pushtetit, që nxitën iniciativat e SHBA për të formuar një sistem ndërkombëtar në përputhje me konceptin e tij të sigurisë."

Melvyn P. Leffler, historian

a) Shpjegoni diferencën në pikëpamjet e shprehura nga historianët Schlesinger dhe Leffler rreth origjinës së Luftës së Ftohtë. **4 pikë**

- Schlesinger dhe Leffler i përkasin dy rrymave të ndryshme të mendimit historik respektivisht asaj të quajtur "orthodokse" dhe "revizioniste".
- Rryma "ortodokse" e gjen shkakun e fillimit të Luftës së Ftohtë tek qasja agresive dhe ekspansioniste e Bashkimit Sovjetik që, sipas historianeve të shkollës "orthodokse", u perceptuan si kërcënuese nga ana e SHBA dhe vendeve evropiane - përëndimore duke çuar kështu në krijimin e një blloku politik-ushtarak të këtyre vendeve dhe në fillimin e një kundërvënies që mori emrin Lufta e Ftohtë.
- Rryma "revizioniste", që nisi të kristalizohej kryesisht në periudhën e Luftës së Vietnamit, mbështet tezën se shkakun e Luftës së Ftohtë ishte qëndrimi ekspansionist i SHBA kryesisht në kuadër ekonomik dhe të gjetjes së tregjeve të reja për produktet amerikane dhe avancimit të sistemit kapitalist. Për rrjedhojë, BS perceptoi këto lëvizje si kërcënuese ndaj sferës së saj të influencës në Evropën Lindore.

b) Jepni një argument në mbështetje të pikëpamjes së Schlesinger. **2 pikë**

Ne përkrahje të tezës së Schlesinger mund të përmenden sidomos qëndrimin i BS kundrejt vendeve të Evropës Lindore pas Luftës së II Botërore apo konfliktit Korean, agresiviteti sovjetik në lidhje me Berlinin, lufta civile në Greqi. BS shkeli marrëveshjet e bëra gjatë viteve të luftës, ku theksohej angazhimi i Fuqive të Mëdha për të lejuar vendet evropiane të bënin zgjedhje të lira e të ndershme (gjë që nuk ndodhi në vendet e kontrolluara nga ushtria sovjetike) si dhe për shkak të rolit të BS në sulmin e Koresë së Veriut ndaj asaj të Jugut (iniciative që mund të ndërmerrej vetëm pasi të ishte marrë konsensusi sovjetik). BS gjithashtu vendosi një bllokade kundrejt Berlinit me mendimin se do të detyronte fuqitë përëndimore ta braktisnin atë dhe gjithë qyteti të bashkohej nën kontrollin sovjetik. Po ashtu, BS përkrahu forcat komuniste në konfliktin civil në Greqi, pavarësisht marrëveshjeve që i linin dorë të lire Britanisë së Madhe dhe SHBA në këtë vend.

c) Jepni një argument në mbështetje të pikëpamjes së Leffler. **2 pikë**

Në përkrahje të tezës së Leffler mund të përmendet fakti se BS ishte shumë i dobësuar pas Luftës II Botërore dhe kishte si prioritet rimëkëmbjen ekonomike. Gjithashtu pas Luftës II Botërore SHBA kishin edhe monopolin e armës atomike. Edhe plani Marshall shikohet prej tyre si një shprehje e ekspansionizmit ekonomik amerikan. Po kështu edhe krijimi i NATO-s. Një tjetër element mund të konsiderohet edhe arma atomike që SHBA e testuan në fund të Luftës II Botërore.

d) Shpesh Lufta e Ftohtë është quajtur edhe "*luftë me prokurë*". Analizoni kuptimin sipas të cilit është përdorur ky term. **4 pikë**

Termi "luftë me prokurë" i referohet faktit që kundërvënia mes SHBA dhe BS gjente shprehjen në luftëra ose konflikte me karakter lokal, por që shkakun kryesor e kishin tek përplasja e interesave mes superfuqive dhe nxiteshin e mbështeteshin prej këtyre të fundit.

## Pyetja 3

## Dokumenti 1

*"Organizata jonë - "Solidariteti" - është rritur në një lëvizje të fuqishme për çlirimin shoqëror dhe moral. Populli, i çliruar nga skllavëria e frikës dhe apatisë, bëri thirrje për reforma dhe përmirësime. Ne bëmë një luftë të vështirë për ekzistencën tonë. Kjo ishte dhe është ende një mundësi e madhe për të gjithë vendin. Mendoj se shënoi edhe rrugën që duhet të bënin autoritetet, nëse mendonin për një shtet të qeverisur në bashkëpunim dhe pjesëmarrje të të gjithë qytetarëve. "Solidariteti", si lëvizje sindikale, nuk arriti të fitonte pushtetin dhe nuk u kthye kundër rendit të vendosur kushtetues. Gjatë 15 muajve të ekzistencës ligjore të "Solidaritetit" askush nuk u vra apo u plagos si rezultat i aktiviteteve të tij. Lëvizja jonë u zgjerua me hapa të mëdhenj. Por ne u detyruam të zhvillonim një luftë të pandërprerë për të drejtat tona dhe lirinë e veprimtarisë, duke i vendosur në të njëjtën kohë vetes kufizimet e pashmangshme. Programi i lëvizjes sonë buron nga ligjet dhe rendi themelor moral. Burimi i vetëm dhe themelor i forcës sonë është solidariteti i punëtorëve, fshatarëve dhe inteligjencës, solidariteti i kombit, solidariteti i njerëzve që kërkojnë të jetojnë me dinjitet, të vërtetën dhe në harmoni me ndërgjegjen e tyre.*

*Lech Valessa, Nobel Peace Prize acceptance speech, 1983*

- a) Shpjegoni kontekstin shoqëror, politik dhe ekonomik në të cilin lindi dhe u zhvillua organizata sindikale "Solidariteti" dhe veprimtaria e saj. **4 pikë**

Pas Luftës II Botërore, edhe në Poloni, ashtu si në vendet e tjera të Evropës Lindore, u vendos regjimi komunist. Ky regjim u perceptua si i vendosur nëpërmjet bajonetave sovjetike dhe asnjëherë nuk u pranua nga populli polak. Në periudha të ndryshme, pati lëvizje të rëndësishme protestë ndaj regjimit. Fundi i viteve '70 u shoqërua me një ashpërsim të krizës ekonomike dhe sociale në Poloni dhe situata e lirive individuale njerëzore ishte e erret. Në këtë kontekst, në qytetin-port Gdansk (shume të rëndësishëm në Poloni) u krijua një organizatë sindikale e quajtur "Solidariteti" (Solidarnosc) që ishte e pavarur nga organizata sindikale e regjimit komunist. Sigurisht që ajo ishte e jashtëligjshme (sipas ligjeve të kohës së regjimit) dhe hasi në pengesa të shumta nga ana e këtij të fundit. Veprimtaria e "Solidaritetit" u bë aq shqetësuese sa që, me nxitjen e BS, autoritetet komuniste polake vendosën gjendjen e jashtëzakonshme në vitin 1981, duke arrestuar liderët dhe përkrahësit e organizatës dhe duke e goditur rëndë veprimtarinë e saj. Megjithatë, lëvizja vazhdoi duke çuar në vitin 1989 në zhvillimin e zgjedhjeve të para të lira që pas Luftës II Botërore në Poloni dhe rënien e regjimit komunist.

- b) Identifikoni të paktën një lëvizje politike dhe shoqërore të ngjashme me atë të zhvilluar nga "Solidariteti" për sa i përket karakterit paqësor të saj. **1 pikë**

"Solidariteti" gjithnjë mbajti një qëndrim të rezistencës paqësore për arritjen e qëllimeve të saj. Një lëvizje e ngjashme për nga karakteri mund të përmendet ajo e Gandit për fitimin e pavarësisë së Indisë nga Britania e Madhe.

- b) Argumentoni ndikimin e lëvizjes "Solidariteti" në planin ndërkombëtar. **3 pikë**

Veprimtaria e "Solidariteti" si organizata me e madhe me karakter antikomunist në vendet e Evropës Lindore pati një jehonë të madhe në planin ndërkombëtar. Ishte hera e parë që po krijohej dhe zhvillohej një lëvizje e organizuar dhe e mirë menduar por edhe paqësore në vendet e Bllokut Komunist dhe, për këtë arsye, ajo mori një vëmendje shumë të madhe si dhe përkrahje si në planin moral, ashtu edhe atë material nga vendet demokratike perëndimore. Udhëheqësi i organizatës, Lech Valessa u bë figurë qendrore në përpjekjet e popujve të Evropës Lindore për rrëzimin e regjimeve komuniste diktatoriale dhe shkëputjes nga ndikimi sovjetik. "Solidariteti" u kthye në një shembull për vendet e tjera që ndodheshin nën sundimin komunist, duke demonstruar se këmbëngulja dhe masiviteti i lëvizjes ishin më të fortë se represioni i regjimit.

## Pyetja 4

### Dokumenti 1

“Më 25 mars 1939, konti Ciano i paraqet Mbretit Ahmet Zogu një projekttraktat prej 8 pikash. Ky projekt në vetvete ishte një ultimatum që e vinte Shqipërinë nën protektoratin italian dhe cenonte drejtpërdrejt pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit shqiptar. Ky projekttraktat nuk u pranua nga pala shqiptare dhe mbreti këmbënguli me vendosmëri që formulimi i tyre të përputhej me Statutin e shtetit shqiptar dhe të mos prekej sovraniteti i tij.

Më 2 prill 1939, u paraqit një projekttraktat me terma më të buta, por që në thelb përmbante po ato kërkesa të paraqitura më 25 mars 1939. Propozimet e fundit përmblihdeshin në 4 pika.”

*Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi IV. Botimet albanologjike*

### Dokumenti 2

“Më 6 prill, Parlamenti Shqiptar i hodhi poshtë kërkesat ultimative italiane. Mbreti Zog bëri një përpjekje të pashpresë për të shmangur pushtimin. Në mbrëmjen e kësaj date, Mussolini urdhëroi gjeneral Guzzoni, që në çastin e zbarkimit, të zbatonte urdhrat, duke shtypur çdo lloj qëndrese nga ana e shqiptarëve. Në mëngjesin e 7 prillit 1939 u sulmuan, gati në të njëjtën kohë, qytetet bregdetare dhe ditën e nesërme forcat italiane hynë në Tiranë. Me zbarkimin e trupave italian dhe largimin e Ahmet Zogut nga vendi, filloi një periudhë tjetër e historisë së Shqipërisë, ajo e pushtimit italian. Pushtuesi mori masa që në ditët e para për të sanksionuar regjimin e pushtimit.”

*Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi IV. Botimet albanologjike*

a) Çfarë përmbanin katër pikat e propozimit italian që iu paraqitën qeverisë shqiptare më 4 prill 1939?

**4 pikë**

- Kontrollin e të gjithë porteve, komunikacioneve, rrugëve dhe aerodromeve në rast kërcënimi të pavarësisë të Shqipërisë.
- Të vendosej një këshilltar italian në çdo ministri shqiptar, i cili do të ishte, nga ana hierarkike, menjëherë pas rangut të ministrit shqiptar.
- T'u njiheshin italianëve në Shqipëri të njëjtat të drejta qytetare dhe politike si edhe shqiptarëve.
- Ngritja e legatës italiane në Tiranë dhe e legatës shqiptare në Romë në rang ambasadash.

b) Cilat ishin veprimet e ndërmarra nga italianët për të krijuar institucionet në Shqipëri?

**4 pikë**

- Veprimet që u ndërmorën nga italianët synonin të eliminonin pavarësinë e Shqipërisë dhe ta fusnin atë nën suazën institucionale të Italisë fashiste.
- Më 12 prill u mbledh Asambleja Kushtetuese që deklaroi të rrëzuar Mbretërinë Shqiptare dhe abdikoi Kushtetutën e vitit 1928, dhe i ofroi Mbretit Vittorio Emanueli III, Kurorën e Shqipërisë, në formën e një “bashkimi personal”
- Mbreti do të përfaqësohej në Shqipëri nga një Mëkëmbës i Përgjithshëm, me seli në Tiranë.
- U krijua qeveria e parë shqiptare e periudhës së pushtimit e kryesuar nga Shefqet Vërlaci.
- U krijua Këshilli i Epërm Korporativ Fashist që zëvendësoi parlamentin.
- U suprimua Ministria e Jashtme të Shqipërisë dhe krijimi i përfaqësive diplomatike të shtetit shqiptar, si pjesë e shtetit italian.
- U Krijua Partia Fashiste Shqiptare
- U krijua institucioni i Këshillit të Përhershëm pranë Ministrive Shqiptare, qëllimi i të cilit ishte kontrolli dhe drejtimi i administratës shqiptare
- U krijua Këshilli Administrativ i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, ku shumica e anëtarëve ishin italianë.
- U krijuan zyra të shumta për të ndjekur e kontrolluar realizimin e veprave publike.
- Etj.

c) Analizoni rolin e Mëkëmbësit të Përgjithshëm të mbretit në Shqipëri.

**4 pikë**

Mëkëmbësi Francesco Jacconi, do të ushtronte të gjithë pushtetin e Mbretit Vittorio Emanueli III në Shqipëri. Ky post u themelua në bazë të ligjit italian. Mëkëmbësia u cilësua si organ i përhershëm i pushtetit ekzekutiv italian që luante rolin e kryetarit të shtetit shqiptar. Mëkëmbësia varej nga Ministria e Jashtme e Italisë. Kjo e fundit jepte udhëzime dhe porosi për Mëkëmbësin, cilësohej si organ përfaqësues i Perandorit të Italisë dhe Mbretit të Shqipërisë, por epërsi kishte atributi i tij si organ i pushtetit ekzekutiv italian. Në veprimtarinë e brendshme shtetërore, roli i Mëkëmbësit shprehej në miratimin e përbërjes së Këshillit të Lartë Fashiste Korporativ, në emërimin dhe revokimin e sekretarit të Partisë Fashiste Shqiptare, si edhe në emërimin e Këshilltarëve të Përhershëm italianë pranë ministrive.

### **Pyetja 5**

Kultura mesjetare arbërore si dëshmi e vazhdimësisë së kulturës ilire, u gërshetua me ndikimet kulturore evropiane dhe bizantine.

Duke u bazuar në dëshmitë e ndikimit kulturor evropian dhe bizantin në trojet arbërore, analizoni zhvillimet në arsim, gjuhë, letërsi, arkitekturë dhe art figurativ.

**8 pikë**

- Arsimi në trojet arbërore kishte karakter fetar. Kleri kishte në dorë monopolin e dijes, arsimit, artit etj. Shkollat e para u hapën pranë kishave dhe manastireve, ku vendin kryesor e zinte mësimi i fesë dhe gjuhëve kishtare (latinisht, greqisht, e sllavisht), aritmetikë, gjeometri, astronomi, retorikë, muzikë etj. Këto shkolla frekuentoheshin nga shtresat qytetare dhe familjet princërore dhe shumë pak nga fëmijët e familjeve të varfra. Shkolla ishte e organizuar në dy cikle: i ulët dhe i mesëm.
- Gjuhët zyrtare ishin gjuhët kishtare, ndërsa populli përdorte arbërishten.
- Letërsia kishte karakter fetar dhe laik. Botimet fetare në të hershme të dëshmuara në trojet arbërore janë kodikët e famshëm që fillojnë të shkruhen nga shek. VI deri në shek. XII. Këto kodikë krahas riteve fetare përmbajnë edhe të dhëna me karakter historik duke pasqyruar aspekte të ndryshme të jetës shoqërore. Kodikët më të rëndësishëm janë : Kodiku i Purpurit i Beratit (Beratinius 1) dhe Kodiku i Artë (Beratinius 2). Të dy kodikët janë të shkruar në gjuhën greke. Dorëshkrimet në gjuhën latine janë ruajtur në pak, përmendim Kodikun e Shkodrës, nr 83 i shek. XIV, që përmban jetë shenjtorësh.
- Arkitektura ndeshen në ndërtimin e objekteve laike dhe fetare. Ndërtimet me karakter laik janë kështjellat, qytetet, rrugët, ura, ujësjellës etj. Kështjellat dhe qytetet e fortifikuara rrethohen me mure kulla, porta. Numërohen rreth 70 kështjella mesjetare. Edhe qytetet të ndërtuara nga fisnikëria arbërore ishin vendbanime të fortifikuara. Kështu Topiajt ndërtuan kështjellën e Krujës dhe të Petrelës, Balshajt të Shkodrës, Dukagjinët të Lezhës, Komnenët të Beratit etj. Në fshatrat e veriut ndeshen edhe kullat-banesa. Banesa qytetare të shtresës së pasur që i gjejmë si në qytet ashtu edhe në fshat, ishin 2-3 kate dhe ishin të ngjashme me banesat bizantine e më gjerë. Banesat në fshat ishin të thjeshta, ku përveç atyre me gurë gjejnë edhe banesa të ndërtuara me baltë dhe kashtë. Ndërtimet fetare i ndeshim në ndërtimin e kishave, manastireve, katedraleve . Ndeshemi me ndërtime monumentale të pasura ikona, afreske, dysheme me mozaik dhe pllaka mermeri. Në ndërtimet ortodokse mbizotëron stili bizantin, ndërsa në ato katolik mbizotëron stili italian.
- Skulptura u përdorë si dekor zbulues në objektet e kultit, ndërsa ikonat dhe afresket arritën nivele të larta artistike. Vlera të mëdha dekorative përmendim bazilikat e Bylisit, Arrapajt, Butrintit kisha e Rubikut, e Kepit të Rodonit etj. Mozaikët i ndeshim në Tiranë, bazilikën e Linit, Arrapaj etj. Mozaiku i Durrësit është i vetmi në Shqipëri. Piktura haset kryesisht në objektet e kultit, p.sh. në afresket e kishës së Shën Mërisë në Apoloni. Endja në pëlhurë ka mbetur Epitafi i Gllavicës.
- Etj.